

Imoraliteti i paraqitur e ndikon përdorueshmërinë e perceptuar të frazës "bëri vetëvrasje"

Andrew J. Howell, Emilee R. H. Cowan-Nelson, and Victoria D. Cobuz

Departamenti i Psikologjisë, Universiteti MacEwan, Edmonton, AB, Kanada

Përkthyer nga: Dëshirë Sylja, Erlanda Gjeka dhe Ermal Shabani

Abstrakt. *Sfondi:* [Fraza] "bëri vetëvrasje" shpesh konsiderohet më pak e pranueshme se frazat alternative, por gjykimet e tilla dallojnë shumë mes individëve. *Qëllimi:* Ne testuam nëse mbështetja e deklaratave që përmbajnë "bëri vetëvrasje" është më e madhe kur një vetëvrasje paraqitet si e pamoralshme. Ne gjithashtu vlerësuar shkallën e imoralitetit të sugjeruar nga frazat "bëri vetëvrasje" dhe "vdiq nga vetëvrasja" pa dhënë kontekst. *Metoda:* studentët/et pjesëmarrës/e ($N = 154$) lexuan skenarë të një vetëvrasjeje të paraqitur si e pamoralshme dhe një të paraqitur në mënyrë më neutrale dhe gjykan përdorueshmërinë e deklaratave që përdorin "bëri vetëvrasje" ose "vdiq nga vetëvrasja" për secilin skenar. Pastaj, pjesëmarrësit/et zgjedhën ndërmjet "bëri vetëvrasje" ose "vdiq nga vetëvrasja" pa kontekst, në bazë të asaj se cilat fraza nënkuptuan imoralitet dhe dhanë arsytetime me shkrim për zgjedhjet e tyre. *Rezultatet:* Pjesëmarrësit/et i gjykan deklaratat "bëri vetëvrasje" si më së shumti të aplikueshme për skenarin e vetëvrasjes së pamoralshme. Një shumicë e madhe e pjesëmarrësve zgjedhën "bëri vetëvrasje" para "vdiq nga vetëvrasja" për të nënkuptuar imoralitet dhe arsyetimet e pjesëmarrësve për këtë zgjedhje zbuluan disa tematika domethënëse. *Kufizimet:* Manipulimi ynë i imoralitetit ka përdorur nota fetare dhe pjesëmarrësit tanë ishin studentë. Përfundimet : Gjetjet kontribuojnë në bazën empirike për shqetësimet në lidhje me frazën "bëri vetëvrasje", me implikime për reduktimin e stigmës dhe kërkimin e ndihmës.

Fjalë kyçe: vetëvrasje, stigmë, gjuhë

Nuk duroja dot të dëgjoja bëri *vetëvrasje*. Më dukej sikur [i/e dashuri/ja im/e] kreu një krim - plaçkitje, përdhunim ose vrasje.

Sheehan et al., 2018, p. 335

Vetëvrasja është një shkak i vdekjes dhe gjuha jonë duhet ta pasqyrojë këtë; njerëzit vdesin nga vetëvrasja.

Nielsen et al., 2016, p. 4

Shumë njerëz mbajnë qëndrime stigmatizuese ndaj vetëvrasjes (Carpiniello & Pinna, 2017; Cvinar, 2005); si shembuj, vetëvrasja vlerësohet si moralisht e gabuar (Kollareth et al., 2019; Rottman et al., 2014) dhe njerëzit që vdesin nga vetëvrasja shpesh shihen si egoistë dhe të dobët (Batterham et al., 2013). Studimet cilësore të përvojës të të mbijetuarve të tentativës për vetëvrasje ose anëtarëve të familjes së atyre që vdiqën nga vetëvrasja tregojnë gjithashtu se vetëvrasja shoqërohet me perceptime dukshëm negative (e.g., Sheehan et al., 2017; Sheehan et al., 2018). Ndër të mbijetuarit/at e vetëvrasjes, shkallët e stigmës shoqërohen me shqetësim, pikëllim, rrezik më të lartë për vetëvrasje, dhe rritje të ulët personale (Oexle et al., 2018; Scocco et al., 2017). Qëndrimet

stigmatizuese mund të kontribuojnë në hezitimin e njerëzve për të kërkuar ndihmë dhe ndërhyjnë në përpjekjet drejt parandalimit të vetëvrasjes (e.g., Scocco et al., 2017).

Gjuha e vetëvrasjes

Ekziston një shqetësim domethënës ndërmjet disa ofruesve/eve të shërbimeve të kujdesit, përkrahësve/eve të shëndetit mendor dhe të mbijetuarve/eve të tentativave për vetëvrasje në lidhje me përdorimin e frazës "bëri vetëvrasje". Sommer-Rotenberg (1998) identifikoi se fraza nënkupton kriminalitet, çnderim dhe imoralitet dhe argumentoi se përdorimi i saj i vazhdueshëm kontribuon në stigmën rreth vetëvrasjes (shih gjithashtu, p.sh., Agjencia e Shëndetit Publik të Kanadasë, 2018; Silverman, 2006; Sinyor et al., 2018; Organizata Botërore e Shëndetësisë, 2008). Beaton et al. (2013) më tej vuri në pah se termi "bëri" lidhet me shkelje fetare, si në "bëri tradhti bashkëshortore" dhe me sjellje të tjera që konsiderohen mëkatore.

Forumi Kanadez i Gazetarisë mbi Dhunën dhe Traumën (2017) rekomandon përdorimin e frazave alternative si "vdiq nga vetëvrasja" (shih gjithashtu Beaton et al., 2013; Agjencia e Shëndetit Publik të Kanadasë, 2018; Silverman, 2006; Sinyor et al., 2018). Për të dhënë mbështetje empirike të

re këtyre udhëzime, një anketë online me më shumë se 2,000 të rritur anglisht-folës të prekur nga vetëvraska tregoi se frazat "vdiq nga vetëvraska" dhe "ia mori jetën vetës" konsideroheshin më të pranueshme (Padmanathan et al., 2019). [Fraza] "bëri vetëvrasje" shihej përgjithësisht si më pak e pranueshme, por nxori opinione të ndara; për shembull, ata që kishin përvoja të tyre me vetëvrasje e shihnin frazën si të pranueshme në bazë të popullaritetit dhe qartësisë së saj.

Hulumtimi aktual

Faktorët kontekstualë mund të ndikojnë edhe në preferencën për versione të ndryshme gjuhësore. Duke marrë parasysh domethënien negative të frazës si dhe pranueshmërinë përgjithësisht të ulët, ne e testuam hipotezën se vetëvrasjet që paraqiten si të pamoralshme perceptohen të jenë më të përshtatshme me deklaratat që përfshijnë frazën "bëri vetëvrasje" në krahasim me vetëvrasjet që shfaqen si neutrale. Ne gjithashtu testuam nëse individët me qëndrime stigmatizuese ndaj vetëvrasjes e perceptojnë përdorimin e përgjithshëm të deklaratave "bëri vetëvrasje" si më të lartë në krahasim me ata/o që kanë qëndrime më pak stigmatizuese. Së fundi, me anë të një ushtrimi me zgjedhje të detyruara dhe gjykime sasiore, ne testuam hipotezën se pjesëmarrësit perceptojnë se fraza pa kontekst të dhënë "bëri vetëvrasje" nënkuptohet të jetë më e pamoralshme sesa "vdiq nga vetëvraska".

Metoda

Pjesëmarrësit

Sipas analizës së forcës¹, duhen 152 pjesëmarrës për të arritur fuqinë prej .85, duke supozuar një madhësi të vogël efekti dhe $\alpha = .05$ (two-tailed)². Gjithësej 166 studentë nga një universitet kanadez morën pjesë në këtë studim për të marrë kredi në lëndën hyrëse në psikologji. Prej tyre, pesë u përjashtuan nga analiza si pasojë e sjelljeve jashtë detyrës, dy u larguan për mos mbarimin e të paktën 50% të materialeve të studimit dhe pesë u larguan ngase dështuan në artikujt e kontrollimit të vëmendjes (përkrahur më poshtë), duke lënë gjithsej 154 persona. Moshë mesatare e mostrës ishte 19.73 vjet (grupmosha 17-38); 75% ishin femra; 81% e identifikuan anglishten si gjuhën tyre të parë; 77% ishin studentë të vitit të parë; 44% ishin studentë të Arteve; dhe 28% ishin studentë të Shkencave. Asnjë informacion në lidhje me njohuritë dhe përvojat e

¹ Shënim i përkthyesve: Analiza e forcës është kalkulim i cili përdoret për ta matur mostrën më të vogël të nevojshme për një eksperiment, i cili merr për bazë nivelin e nevojshëm të signifkancës, forcës statistikore dhe madhësinë e ndikimit.

pjesëmarrësëve me vetëvrasjen ose gjuhën rreth vetëvrasjes nuk është mbledhur.

Materialet

Matjet e qëndrimeve stigmatizuese ndaj vetëvrasjes

Nënshkalla e stigmës së Batterham dhe kolegëve (2013) Shkalla për Stigmën ndaj Vetëvrasjes përmban 31 elemente (siç janë terme me një apo dy fjalë si "e turpshme") të renditura sipas saktësisë në bazë të së cilës i përshkruajnë njerëzit që vdesin nga vetëvraska, duke përdorur një shkallë matëse me 5 pikë, ku 1 (pajtohem plotësisht) dhe 5 (nuk pajtohem aspak) janë pikat fundore. Ne llogaritëm një rezultat total, ku rezultatet më të larta tregojnë qëndrime më stigmatizuese ndaj vetëvrasjes. Besueshmëria e brendshme e shkallës në studimin aktual qëndroi .93.

Tregime të vetëvrasjes

Kanë qenë dy linja të tregimeve të vetëvrasjes. Të përshtatura nga dy skenarët e krijuar nga a Rottman et al. (2014), historitë ishin të gjata 76 dhe 102 fjalë, duke përjashtuar pjesën që përmbante manipulimin eksperimental. Këto histori përshkruanin vdekjet e vetëshkaktuara të "Michael Dunn" dhe "Louise Parker". Secila u manipulua asisoj që të ndodhë në dy lloje të ndryshme të vetëvrasjes. Në llojin e vetëvrasjes së pamoralshme, fjalë e fundit nxori në pah se familja e të ndjerit e konsideronte vetëvrasjen si të pamoralshme, por kjo fjalë u hoq në llojin e vetëvrasjes neutrale. Në tregimin e Michael Dunn-it më poshtë (shiko Materialin Elektronik Plotësues 1 për tregimin e Louise Parker-it), fjalë e fundit (theksuar me shkronja kursive) u përfshi në versionin e pamoralshëm të vetëvrasjes së të dy tregimeve, domosdoshmërisht me ndryshime të emrave dhe përretrave.

Michael Dunn, i cili ishte 25 vjeç, vdiq më 18 gusht të 2008-ës si rezultat i vetëvrasjes.

Michael-i, kohëve të fundit, kishte filluar një karrierë në hulumtimin e opsioneve alternative të energjisë dhe madje nisi të shënonte sukses në zhvillimin e sistemeve më të qëndrueshme të energjisë. Mbikqyrësi i tij shënoi: "Michael-i kishte mendjen më të jashtëzakonshme. Ai kishte një talent të natyrshëm sa i përket kuptimit të problemeve të ndërlikuara dhe kohëve të fundit, me të krijuar një qasje krejtësisht të re për zhvillimin e energjisë së ujit, ai bëri bujë në nivel kombëtar. Shumë po prisnin me padurim të shohin ndikimin e madh të punës së tij në të ardhmen." Michael la pas një vëlla dhe një motër, Greg-un e Jaclyn-ën, të cilët do ta kujtojnë atë me mall.

² Shënim i përkthyesve: Një metodë e testimit e përdorur në statistikë në të cilën zona kritike e shpërndarjes është e dyanshme dhe testimi nëse mostra është më e madhe apo më e vogël se sa vlerat e dhëna.

Motra e tij, Jaclyn, tha se familja janë tejet të shqetësuar që veprimet e Michael-it shpërfillën shenjtërinë e jetës, që pastërtia e shpirtit të tij ishte njollësuar dhe epërsia e shenjtë e jetës njerëzore ishte shkelur. Familja e konsideruan vdekjen e tij si mëkat dhe kundër rregullave të rendit natyror.

Artikujt e kontrollimit të manipulimit

Pjesëmarrësit vlerësuan secilën histori duke marrë parasysh se si e konsideruan familja të ndjerin - sa të pamoralshëm, egoist, të dobët dhe me sa gjasë që do të dënohet në botën tjetër. Secili vlerësim u bë me anë të një shkalle matëse me 7 pikë, ku 1 (pajtohem plotësisht), dhe 7 (nuk pajtohem aspak) janë pikat fundore, dhe 4 (neutrale) është pikë mesatare. Ne i mblodhëm këto vlerësime në mënyrë që të nxjerrim një indeks të përgjithshëm të së pamoralshmes për skenarët e vetëvrasjes neutrale (mesatarja $\alpha = .64$) dhe skenarët e vetëvrasjes së pamoralshme (mesatarja $\alpha = .82$).

Gjykimet e deklaratave në çift

Pjesëmarrësit u udhëzuan ta vendosin vetën në pozitën e familjeve të njerëzve që ishin përshkruar në tregimet e vetëvrasjeve dhe të vlerësojnë (për gjashtë palë deklarata) se cila nga thëniet në çdo palë do të kishte më shumë gjasa të përdoret nga të dashurit e ndonjë të ndjeri specifik. Prandaj, për të gjashtë palët e deklaratave, komentet në secilën palë u vlerësuan veçmas në lidhje me dy tregimet e lexuara nga një pjesëmarrës, për një total prej 12 vlerësimesh. Për këto vlerësime, udhëzimet e plota vijuan kështu:

Në pjesën e mëposhtme, detyra juaj do të jetë të zgjedhni se cila nga deklaratat nga këto në çift ka më shumë gjasa të thuhet nga të dashurit e Louise-ës apo të Michael-it.

Për të treguar zgjedhjen tuaj, rrethoni një numër nga shkalla me 7 pikë për secilën palë deklaratash. Për çdo palë që e shikoni, mundohuni të paramendoni veten me familjen e secilit prej individëve dhe vlerësoni se cila nga deklaratat përshtatet më së miri.

Për secilën palë deklaratash, (p.sh., A. Vëllai ynë i dashur vdiq nga vetëvrasja; B. Vëllai ynë i dashur bëri vetëvrasje; shih Materialet elektronike plotësuese 1 për grupin e plotë të çifteve të deklaratave), pjesëmarrësit përcaktuan shkallën në të cilën familja do ta preferonte një deklaratë mbi tjetrën duke përdorur një shkallë vlerësimi prej 7 pikësh: (1) *preferoj deklaratën A plotësisht*, (2) *preferoj deklaratën A në masë të arsyeshme*, (3) *preferoj deklaratën A pjesërisht*, (4) *nuk kam preferencë të madhe për deklaratën A ose B*, (5) *preferoj deklaratën B pjesërisht*, (6) *preferoj deklaratën B në mënyrë të arsyeshme* dhe (7) *preferoj deklaratën B plotësisht*. Për një palë të veçantë deklaratash, vlerësimi për historinë e Louise-s ishte ndarë fizikisht nga vlerësimi përkatës për historinë e Michael-it duke ndërthurur vlerësimet e elementeve nga palë të tjera. Veç kësaj,

rendi në të cilin çiftet e deklaratave u përqendruan në tregimet e Louise kundrejt tregimeve të Michael u ndryshua sistematikisht. Ne mblodhëm vlerësimet për gjashtë palët e deklaratave, duke përdorur vlerësimin e kundërt përkatës, për të nxjerrë dy tregues që shfaqin se sa janë mbështetur deklaratat "bëri vetëvrasje" në lidhje me rastin e vetëvrasjes së pamoralshme dhe me rastin e vetëvrasjes neutrale. Pikët më të larta pasqyruan pajtueshmëri më të lartë me frazën "bëri vetëvrasje" për të dy treguesit. Në bazë të palëve të deklaratave, u evidentua besueshmëri e mirë e brendshme (vlerat α luanin mes 0.85 dhe .94 gjatë kushteve eksperimentale).

Artikujt e kontrollimi të vëmendjes

Dy artikuj, të ndërthurur ndërmjet vlerësimeve të çiftit të deklaratave u përdorën për të përcaktuar nëse pjesëmarrësit ishin të vëmendshëm gjatë studimit. Konkretisht, në këta artikuj u tha, "Me qëllim të sigurimit të vlefshmërisë së përgjigjeve të pjesëmarrësve, ju lutem rrethoni numrin 6 në shkallën e mëposhtme" (me "6" e zëvendësuar me "2" për artikullin e dytë). Pjesëmarrësit që dështuan në njërin nga pyetjet u hoqën nga grupi i të dhënave.

Detyrat shtesë

Pjesëmarrësit zgjedhën ndërmjet frazave pa kontekst të dhënë "bëri vetëvrasje" dhe "vdiq nga vetëvrasja" për sa i përket asaj, se cila nga to sugjeronte se një vetëvrasje ishte e pamoralshme. Ata pastaj shpjeguan zgjedhjet e tyre në pyetje të hapura. Pjesëmarrësit vlerësuan gjithashtu frazat "bëri vetëvrasje" dhe "vdiq nga vetëvrasja" për sa i përket masës në të cilën secila frazë e sugjeroi (veçmas) të pamoralshmen, keqbërjen, të paligjshmen dhe mëkatën, duke përdorur shkallët 6-pikëshe me pikat fundore 1 (aspak) dhe 6 (shumë). Mesatarja e këtyre vlerësimeve për frazën "bëri vetëvrasje" ishte $\alpha = .87$ dhe "vdiq nga vetëvrasja" ($\alpha = .90$).

Dizajni i studimit dhe analiza e të dhënave

Studimi përdori një 2 (Lloji i vetëvrasjes: skenari vetëvrasje-e pamoralshme kundër skenarit vetëvrasje-neutrale) \times 2 (Çifti i historisë të vetëvrasjes: skenari vetëvrasje-neutrale e Louise Parker/Skenari i vetëvrasje-e pamoralshme i Michael Dunn kundër skenarit të vetëvrasjes së pamoralshme Louise Parker/Skenarit të vetëvrasjes neutrale të Michael Dunn) \times 2 (Rendi i vetëvrasjes: skenari i parë vetëvrasje neutrale kundrejt skenarit të parë vetëvrasje-e pamoralshme) dizajn të përzier faktorial eksperimental. Pjesëmarrësit lexuan një skenar të vetëvrasjes neutrale dhe një skenar të vetëvrasjes së pamoralshme (duke e bërë llojin e vetëvrasjes një faktor brenda

pjesëmarrësve), ndërsa çifti i historisë së vetëvrasjes dhe rendi i vetëvrasjes u manipuluan midis pjesëmarrësve.

Të tre hipotezat u testuan, përkatësisht, me (1) një analizë e përzier të variancës $2 \times 2 \times 2$ (ANOVA)³ në mesataret e pjesëmarrësve në të cilat është perceptuar aplikimi i deklaratave që përmbajnë "bëri vetëvrasje"; (2) korrelacionin e dyfishtë në mes të Shkallës së Stigmës ndaj Vetëvrasjes për aplikimin e përgjithshëm të perceptuar në deklaratat "bëri vetëvrasje"; dhe (3) një test binomial në qoftëse deklarata "bëri vetëvrasje" është zgjedhur për të sugjeruar pamoralitetin mbi deklaratën "vdiq nga vetëvrasja" në një proporcion më të madh se .50, dhe një *t* test për të vendosur nëse "bëri vetëvrasje" kishte përgjithësisht një nivel më të lartë të jomoralitetit sesa "vdiq nga vetëvrasja".

Procedura

Studimi u aprovua nga bordi i etikës të universitetit të autorëve. Para se të regjistroheshin në studim online, pjesëmarrësit/et kishin mundësinë të informoheshin mbi fokusin e hulumtimit në temën e vetëvrasjes. Brenda sesioneve eksperimentale, forma e pëlqimit e përshkroi studimin si ekzaminim i aspekteve të perceptimeve të studentëve mbi vetëvrasjen dhe vlerësimin e deklaratave në lidhje me skenarë të ndryshëm ndaj vetëvrasjes. Forma e pëlqimit ftoi pjesëmarrësit/et të mos plotësonin studimin në qoftë se tema e vetëvrasjes ishte temë e ndjeshme për ta; asnjë pjesëmarrës/e nuk e ka marrë këtë vendim, ndoshta për shkak të vetëdijesimit të tyre mbi fokusin e studimit para se të arrinin për sesionet e tyre eksperimentale.

Gjatë semestrit të vjeshtës në vitin 2019, autori i dytë (një student i psikologjisë) mbajti disa sesione të mbledhjes së të dhënave fizikisht, secila duke zgjatur për afërsisht 30 minuta. Edhe pse seancat përfshinë nga 4 deri në 39 pjesëmarrës/e për një seancë, pjesëmarrësit/et përfunduan studimin të pavarur nga njëri-tjetri. Pas pëlqimit, pjesëmarrësit/et u vendosën në mënyrë rastësore në një nga dy kushtet e çiftit të historisë së vetëvrasjes ($n = 75$ dhe $n = 79$) dhe një nga dy kushtet e rendit të vetëvrasjes ($n = 81$ dhe $n = 73$). Më pas, studimi u administrua vetë: Pjesëmarrësit/et përfunduan matjet e qëndrimeve stigmatizuese ndaj vetëvrasjes; lexuan çiftet e caktuara të skenarëve të vetëvrasjes (d.m.th., një skenar vetëvrasjeje të pamoralshme dhe një skenar i vetëvrasjes neutrale); u përgjigjën në artikujt e kontrollimit të manipulimit; përfunduan gjashtë vlerësimet e para të çiftit të deklaratave (d.m.th., tre vlerësime për secilën prej dy skenarëve); rilexuan të dy skenarët dhe plotësuan vlerësimet e gjashtë çifteve të fundit të deklaratave (me një artikulli për kontroll të vëmendjes duke u shfaqur gjithashtu në mes të çdo grupimi të vlerësimeve të deklaratave të çifteve); kryen detyrën me zgjedhje të detyruar dhe ofruan arsyet me shkrim për zgjedhjet e tyre; vlerësuan jomoralitetin, keqbërjen,

paligjshmërinë dhe mëkatën që lidhen me deklaratat "bëri vetëvrasje" dhe "vdiq nga vetëvrasja"; dhe plotësuan pyetjet demografike dhe një përmbledhje studimore. Në këtë studim nuk është manipuluar apo matur asnjë variabël tjetër; të gjitha të dhënat e studimit janë raportuar këtu.

Rezultatet

Kontrolli i manipulimit

Një ANOVA $2 \times 2 \times 2$ në indeksin e kontrollit të manipulimit konfirmoi një efekt kryesor të llojit të vetëvrasjes: jomoraliteti i perceptuar ishte dukshëm më i lartë për skenarët e pamoralshëm të vetëvrasjes ($M = 17.69$, $SD = 3.80$) sesa skenarët neutralë të vetëvrasjes ($M = 8.19$, $SD = 3.14$), $F(1,150) = 650.93$, $p < .001$, $\eta^2 = .813$. Efekti i vetëm tjetër ishte një ndërveprim ndërmyjet Llojit të Vetëvrasjes \times Çiftit të Historisë së Vetëvrasjes, $F(1,150) = 5.85$, $p = .017$, $\eta^2 = .038$. Ky efekt i paparashikuar dhe me përmasa të vogla në kontrollin tonë të manipulimit nuk është ndjekur më tej.

Përdorueshmëria e perceptuar e deklaratave që përmbajnë "bëri vetëvrasje"

Një ANOVA $2 \times 2 \times 2$ u krye mbi mesataren e pjesëmarrësve për përdorueshmërinë e perceptuar të deklaratave që përmbajnë "bëri vetëvrasje" (shih Tabelën 1 për statistikat konkluzive). Siç u parashikua, kishte një efekt kryesor domethënës mbi llojin e vetëvrasjes, me rezultate më të mëdha për skenarët vetëvrasje e pamoralshme ($M = 31.50$, $SD = 9.07$) sesa skenarët neutralë të vetëvrasjes ($M = 17.39$, $SD = 8.37$). Efekti tjetër i vetëm që u shfaq ishte një efekt kryesor i çiftit të historisë së vetëvrasjes, i tillë që pjesëmarrësit i perceptuan deklaratat që përmbajnë "bëri vetëvrasje" si më të zbatueshme për çiftin e skenarëve në të cilët vdekja e Louise u përshkrua si e pamoralshme dhe vdekja e Michael u përshkrua në mënyrë neutrale në lidhje me çiftin e përparmë, një efekt ky i paparashikuar dhe me përmasa të vogla që nuk është ndjekur më tej.

³ Shënim i përkthyesve: Është një lloj i dizajnit eksperimental që lejon hulumtuesëve të kuptojnë efektet të tri variablave të pavarura (të trija me dy nivele) në një variabël të varur

Qëndrimet stigmatizuese dhe përdorueshmëria e deklaratave “bëri vetëvrasje”


stigmatizuese ndaj vetëvrasjes nuk e kanë parashikuar përdorueshmërinë e perceptuar të deklaratave “bëri vetëvrasje”, $r(148) = .11, p = .199$.

Ne ndërlidhëm rezultatet e pjesëmarrësve në shkallën e Stigmës së Vetëvrasjes me vlerësimet e tyre për palët e deklaratave mbi perceptimin e përdorimit të përgjithshëm të deklaratave "bëri vetëvrasje". Për dallim nga hipoteza jonë, qëndrimet

Tabela 1. Rezultatet e 2 (Lloji i vetëvrasjes) \times 2 (pala e historive të vetëvrasjeve) \times 2 (renditja e vetëvrasjes) ANOVA mbi përdorueshmërinë e perceptuar të deklaratave "bëri vetëvrasje"

<i>Efekti</i>	<i>F(1,150)</i>	<i>p</i>	<i>η^2</i>
<i>Lloji i vetëvrasjes (vetëvrasje e pamoralshme në krahasim me vetëvrasjen neutrale)</i>	119,86	<.001	.444
<i>Çifti i tregimeve të vetëvrasjeve (vetëvrasja e pamoralshme Michael vs. Louise)</i>	5.26	.023	.034
<i>Renditja e vetëvrasjes (vetëvrasje e pamoralshme 1 vs. 2)</i>	2.11	.149	.014
<i>Lloji i vetëvrasjes \times Pala e tregimeve të vetëvrasjeve</i>	0.01	.939	.000
<i>Lloji i vetëvrasjes \times Renditja e vetëvrasjes</i>	0.35	.555	.002
<i>Pala e tregimeve të vetëvrasjeve \times Renditja e vetëvrasjes</i>	0.41	.522	.003
<i>Lloji i vetëvrasjes \times Pala e tregimeve të vetëvrasjeve \times Renditja e vetëvrasjes</i>	0.18	.673	.001

Tabela 2. Përqindja e pjesëmarrësve që nxorën arsye të ndryshme mbi zgjedhjen "bëri vetëvrasjen" të jetë më e pamoralshme se "vdiq nga vetëvrasja"



Shënim. Përqindjet pasqyrojnë numrin e të anketuarve që kanë dhënë në të paktën një shpjegim për atë kategori. $n = 137$.

Zgjedhja dhe arsyetimi i frazave pa kontekst dhe sugjeruese të imoralitetit dhe vlerësimeve që lidhen me imoralitet

Sipas një testi binomial⁴, hipoteza se pjesëmarrësit do zgjidhnin më shpesh frazën pa kontekst të dhënë "bëri vetëvrasje" si frazë që sugjeron imoralitet më shumë se sa "vdiq nga vetëvrasja" ishte statistikisht e dallueshme, $p < .001$. Gjithsej 91.4% e pjesëmarrësve (139 prej 152 që përfunduan detyrën) vendosën që fraza "bëri vetëvrasje" nënkuptohet të jetë e pamoralshme.

Në mesin e pjesëmarrësve të cilët e kanë zgjedhur "bëri vetëvrasje" si frazë që sugjeron jomoralitet, 137 nga ta dhanë arsye me shkrim për të mbështetur zgjedhjet e tyre. Ne klasifikuam shpjegimet e tyre të hapura në kategoritë: mëkatuese/krim/e gabuar; e paramenduar/e fajësueshme; dhembshuri e ulët; egoiste; dhe "të tjera". Po ashtu, ne klasifikuam shpjegimet e hapura bazuar në atë se pse "vdiq nga vetëvrasja" nuk nënkuptohet të jetë e pamoralshme në kategoritë e kuptueshme/natyrore/ si një vdekje tjetër; jo përgjegjëse/pa faj; e respektueshme/dhembshur/më pak e ashpër; më pak stigmatizuese; dhe "të tjera". Më pas, ne kategorizuam se a kishte paraqitur secili pjesëmarrës të paktën një argument për secilën prej këtyre kategorive. Tabela 2 na tregon se arsyet më të shpeshta për vlerësimin e "bëri vetëvrasje" si frazë më e pamoralshme u përputhën me kategoritë mëkatuese/krim (p.sh., "Kur ndonjë fraze ia shton fjalën "bëri", tingëllon si krim" Pjesëmarrësi 16) dhe e paramenduar/e fajësueshme (p.sh., "bëri vetëvrasje" tingëllon sikur faji të jetë tërësisht i personit", Pjesëmarrësi 113). Arsyet më të shpeshta për vlerësimin e "vdiq nga vetëvrasja" u përputhën me kategoritë e kuptueshme/natyrore/si një vdekje tjetër (p.sh., "Kur dikush thotë "vdiq nga vetëvrasja" identifikohet me vdekjet në çdo mënyrë tjetër, qoftë aksident apo sëmundje" Pjesëmarrësi 51) dhe jo përgjegjës/pa faj (p.sh., "Nënkupton se nuk ishte në duart e të ndjerit" Pjesëmarrësi 70).

Shpjegimet e dhëna nga pjesëmarrësit ($n = 13$) që zgjedhën "vdiq nga vetëvrasja" si frazë më pak të pamoralshme nuk u kategorizuan për shkak të numrit të tyre të vogël. Sidoqoftë, kishte disa arsye për të parë frazën "vdiq nga vetëvrasja" si të pamoralshme, këtu përfshirë "Është duke theksuar rezultatit e veprimt" (Pjesëmarrësi 54) dhe "Duket si mënyrë e të folurit të një personi në mohim..." (Pjesëmarrësi 151), përderisa shembujt e argumenteve për ta gjykuar "bëri vetëvrasje" si frazë e cila sugjeron më pak jomoralitet përfshinë, "Më pranues, pa turp" (Pjesëmarrësi 30) dhe "Pranon aktin e vetëvrasjes" (Pjesëmarrësi 114).

Në fund, ne krahasuam vlerësimet mesatare të së pamoralshmes të perceptuar, të së gabuarës, ilegales dhe mëkatit për dy frazat e pavaruara. Ashtu siç është parashikuar, "bëri vetëvrasje" ($M = 4.36$; $SD = 1.21$) në këtë indeks u vlerësua dukshëm më lartë në krahasim me "vdiq nga vetëvrasja" ($M = 2.17$; $SD = 1.14$), $t(151) = 14.66$, $p < .001$, $\eta^2 = .587$.

⁴Shënim i përkthyesve: Ky test përdorë të dhënat e mostrës për të përcaktuar nëse proporcioni i popullatës i një niveli në variable binare (apo dikotomike) është e barazvlefshme me një vlerë specifike të pohuar.

Diskutimi

Rezultatet mbështetën hipotezën se deklaratat "bëri vetëvrasje" u perceptuan të ishin më të përdorshme për një vetëvrasje të përshkruar si të pamoralshme sesa një vetëvrasje e përshkruar si neutrale. Kjo tregon se gjykimet e përdorueshmërisë të deklaratave "bëri vetëvrasje" ndryshojnë sistematikisht si në bazë të mënyrës në të cilën një vdekje nga vetëvrasje portretizohet. Qëndrimet e perceptuesve ndaj vetëvrasjes nuk parashikonin tendencën e tyre për të miratuar në mënyrë të ndryshme përdorueshmërinë e deklaratave "bëri vetëvrasje". Kjo me gjasë reflekton efektin e madh të kontekstit të pamoralitetit të paraqitur për të shpjeguar variacionin në përdorueshmërinë e frazës së perceptuar dhe gjasat që pikëpamjet personale të pjesëmarrësve ndaj vetëvrasjes luajnë një rol më të vogël kur atyre u kërkohet të bëjnë gjykime nga këndvështrimi i dikujt tjetër. Në një detyrë tjetër me zgjedhje të detyruar, shumica e pjesëmarrësve zgjodhën "bëri vetëvrasje" mbi "vdiq nga vetëvrasje" për të sugjeruar jomoralitetin dhe arsyetimet e tyre me shkrim për këtë zgjedhje ishin kuptimplota (p.sh., "bëri vetëvrasje" u përshkrua si nënkuptim i veprimit të qëllimshëm dhe të gabuar), dhe ata e vlerësuan "bëri vetëvrasje" më lartë se "vdiq nga vetëvrasje" në indeksin sasior të jomoralitetit të perceptuar.

Kufizimet

Studimi ynë kërkon, dhe shpresojmë që frymëzon, kërkime të mëtejshme mbi këtë temë, pjesërisht për të adresuar kufizimet e punës aktuale. Ne kemi përdorur një manipulim të jomoralitetit me nota të dukshme fetare; dëshmi se fjala "bëri" thekson tema të mëkatit (Beaton et al., 2013) fton mundësinë që çiftimi i vetëvrasjeve të përshkruara në mënyrë të pamoralshme me frazën "bëri vetëvrasje" pasqyron në mënyrë të veçantë natyrën fetare të manipulimit tonë. Manipulimi ynë ishte i bazuar në Rottman dhe kolegët (2014) duke gjetur se perceptimet e vetëvrasjes si të pamoralshme kanë një bazë në shqetësimet e pastërtisë/shenjtërisë, madje edhe tek individët jofetarë. Asocimi i përgjithshëm mes vetëvrasjes dhe shenjtërisë legjitimon natyrën fetare të manipulimit tonë të jomoralitetit; megjithatë, gjetjet tona duhet të testohen për përgjithësimin e tyre ndaj manipulimeve të jomoralitetit që nuk janë me nota fetare. Për shembull, Kollareth et al. (2019) treguan me stimuj të skenarëve jofetarë se qëllimshmëria e vetëvrasjeve parashikon jomoralitetin e tyre të gjykuar dhe e bënë këtë të pavarur ndaj reaksioneve emocionale kryesore të lidhura me pastërtinë/shenjtërinë; në mënyrë interesante, gjetjet e tyre sugjerojnë mundësinë që, në studimin tonë, çiftimi i vetëvrasjeve të përshkruara në mënyrë të pamoralshme me

frazën "bëri vetëvrasje" pasqyron një lidhje mes qëllimit të perceptuar të një vetëvrasjeje dhe konotacionit përfaqësues të termit "bëri", një mundësi kjo e mbështetur nga gjetjet tona cilësore.

Në pjesën e studimit të bazuar në skenar, pjesëmarrësit vlerësuan gjasat që anëtarët e familjes do të përdornin deklaratat që përmbajnë "bëri vetëvrasje" ose "vdiq nga vetëvrasje"; ata nuk i gjykuan pikëpamjet e tyre ndaj këtyre formave gjuhësore dhe përdorimi i gjuhës së tyre nuk u vlerësua. Ne manipuluan llojin e vetëvrasjes si një faktor brenda subjekteve, duke i shtyrë pjesëmarrësit të bëjnë gjykime të përdorueshmërisë së perceptuar të dy frazave ndaj dy skenarëve. Detyra me zgjedhje të detyruar pasoi vlerësimet e çiftit të deklaratave dhe për këtë arsye mund të jenë ndikuar nga kjo përvojë e mëparshme. Pjesëmarrësit tanë ishin studentë të psikologjisë të cilët u vetëpërzgjodhën në studimin tonë; përgjigjet e tyre mund të mos jenë tipike për të rriturit në përgjithësi ose atyre që janë shumë të ndjeshëm ndaj temës së vetëvrasjes.

Drejtimit e ardhshme dhe implikimet

Përderisa studimi aktual tregoi se konteksti i jomoralitetit rriti përdorueshmërinë e perceptuar të [frazës] "bëri vetëvrasje", kërkimet e ardhshme mund të shqyrtojnë nëse kontekstet e tjera kanë efekte të kundërta; për shembull, një përgjigje shumë empatike ndaj një vdekjeje nga vetëvrasje mund të zvogëlojë përdorueshmërinë e perceptuar të deklaratave "bëri vetëvrasje". Përtej qëndrimeve stigmatizuese, dallimet individuale mund të parashikojnë përdorueshmërinë e perceptuar të "bëri vetëvrasjes"; për shembull, njerëzit që janë politikisht më konservatorë ose më fetarë prirën ta shohin vetëvrasjen si më të pamoralshme (Rottman et al., 2014) dhe për këtë arsye mund të mbështesin më fort [frazën] "bëri vetëvrasje". Hulumtimet e ardhshme mund të shqyrtojnë gjithashtu nëse ekspozimi ndaj formave të ndryshme gjuhësore ndikon në qëndrimet e mëvonshme ndaj vetëvrasjes. Përgjatë këtyre linjave, një studim i kohëve të fundit tregoi se pjesëmarrësit e përgatitur me gjuhë provokuese dhe jo provokuese të lidhura me vetëvrasjen më pas e përdorën më shumë referencën ndaj të cilës ishin ekspozuar (Arendt et al., 2018), me implikime të mundshme të mëvonshme për qëndrimet e tyre ndaj vetëvrasjes.

Linja aktuale e hulumtimit mund të ketë implikime për përpjekjet për të reduktuar stigmën e lidhur me vetëvrasjen. Një efekt shkatërrues i qëndrimeve të tilla është rritja e pragut për të kërkuar ndihmë tek ata të ndikuar nga vetëvrasje. Rritja e ndërjegjësimin në lidhje me gjuhën e vetëvrasjes, duke përfshirë këtu ndërjegjësimin për rolin e dallimeve individuale dhe ndikimet e situatës në perceptimet e frazës "bëri vetëvrasje", mund të përfshihet brenda ndërhyrjeve ekzistuese

të bazuara në prova që tregojnë reduktim të qëndrimeve stigmatizuese ndaj vetëvrasjes (e.g., Rogers et al., 2018). Efekti i këtyre fushatave do të kërkonte testimin e rezultateve të tilla si: qëndrimet stigmatizuese ndaj vetëvrasjes dhe miratimi i formave të ndryshme gjuhësore në lidhje me vetëvrasjen. Në fund të fundit, të kuptuarit e vazhdueshëm e gjuhës së vetëvrasjes mund të promovojë pikëpamje ndaj vetëvrasjes të cilat janë të mbushura me dhembshuri në vend të përbuzjes.

Materiali suplementar elektronik

Materiali elektronik plotësues është i disponueshëm me versionin online të artikullit në <https://doi.org/10.1027/0227-5910/a000767>

ESM 1. Historia e vetëvrasjes së Louise Parker dhe stimujt e vlerësimit të çiftit të deklaratave

Referencat

- Arendt, F., Scherr, S., Niederkrotenthaler, T., & Till, B. (2018). The role of language in suicide reporting: Investigating the influence of problematic suicide referents. *Social Science & Medicine*, 208, 165–171. <https://doi.org/10.1016/j.socscimed.2018.02.008>
- Batterham, P. J., Calear, A. L., & Christensen, H. (2013). The Stigma of Suicide Scale: Psychometric properties and correlates of the stigma of suicide. *Crisis*, 34, 13–21. <https://doi.org/10.1027.0227-5910/a000156>
- Beaton, S. J., Forster, P. M., & Maple, M. (2013). Suicide and language: Why we shouldn't use the 'C' word. *InPsych*, 35, 30–31.
- Carpiniello, B., & Pinna, F. (2017). The reciprocal relationship between suicidality and stigma. *Frontiers in Psychiatry*, 8, 35. <https://doi.org/10.33889/fpsy.2017.00035>
- Cvinar, J. G. (2005). Do suicide survivors suffer social stigma: A review of the literature. *Perspectives in Psychiatric Care*, 41, 14–21. <https://doi.org/10.1111/j.0031-5990.2005.00004.x>
- Kollareth, D., Allam, A., & Russell, J. A. (2019). On judging the immorality of someone having taken his or her own life. *Social Cognition*, 37, 547–570. <https://doi.org/10.1521/soco.2019.37.6.547>
- Nielsen, E., Padmanathan, P., & Knipe, D. (2016). Commit* to change? A call to end the publication of the phrase "commit* suicide". *Wellcome Open Research*, 1, 21. <https://doi.org/10.12688/wellcomeopenres.10333.1>
- Oexle, N., Feigelman, W., & Sheehan, L. (2018). Perceived suicide stigma, secrecy about suicide loss and mental health outcomes. *Death Studies*, 44(4), 248–255. <https://doi.org/10.1080/07481187.2018.1539052>
- Padmanathan, P., Biddie, L., Hall, K., Scowcroft, E., Nielsen, E., & Knipe, D. (2019). Language use and suicide: An online cross-sectional survey. *PLoS ONE*, 14(6). <https://doi.org/10.1371/journal.pone.0217473>
- Public Health Agency of Canada. (2018). Language matters: Safe language and messages for suicide prevention. Government of Canada.
- Rogers, M. L., Schneider, M. E., Gai, A. R., Gorday, J. Y., & Joiner, R. E. (2018). Evaluation of two web-based interventions in reducing the stigma of suicide. *Behaviour Research and Therapy*, 109, 49–55. <https://doi.org/10.1016/j.brat.2018.08.001>

- Rottman, J., Keleman, D., & Young, L. (2014). Tainting the soul: Purity concerns predict moral judgments of suicide. *Cognition*, 130, 217–226. <https://doi.org/10.1016/j.cognition.2013.11.007>
- Scocco, P., Preti, A., Totaro, S., Ferari, A., & Toffol, E. (2017). Stigma and psychological distress in suicide survivors. *Journal of Psychosomatic Research*, 94, 39–46. <https://doi.org/10.1016/j.jpsychores.2016.12.016>
- Sheehan, L. L., Corrigan, P. W., Al-Khouja, M. A., & the Stigma of Suicide Research Team (2017). Stakeholder perspectives on the stigma of suicide attempt survivors. *Crisis*, 38(2), 73–81. <https://doi.org/10.1027/0227-5910/a000413>
- Sheehan, L. L., Corrigan, P. W., Al-Khouja, M. A., Lewy, S. A., Major, D. R., Mead, J., Redmon, M., Rubey, C. T., & Weber, S. (2018). Behind closed doors: The stigma of suicide loss survivors. *OMEGA – Journal of Death and Dying*, 77, 330–349. <https://doi.org/10.1177/0030222816674215>
- Silverman, M. H. (2006). The language of suicidology. *Suicide and Life-Threatening Behavior*, 36, 519–532. <https://doi.org/10.1521/suli.2006.36.5.519>
- Sinyor, M., Schaffer, A., Heisel, M. J. H., Picard, A., Adamson, G., Cheung, C. P., Katz, L. Y., Jetly, R., & Sareen, J. (2018). Media guidelines for reporting on suicide: 2017 update of the Canadian Psychiatric Association policy paper. *Canadian Journal of Psychiatry*, 63, 182–196. <https://doi.org/10.1177/0706743717753147>
- Sommer-Rotenberg, D. (1998). Suicide and language. *Canadian Medical Association Journal*, 159, 239–240.
- The Canadian Journalism Forum on Violence and Trauma. (2017). *Mindset: Reporting on mental health* (2nd ed.). <https://www.Mindset-mediaguide.ca>
- World Health Organization. (2008). *Preventing suicide: A resource for media professionals*. https://www.who.int/mental_health/prevention/suicide/resource_media.pdf

Historia

- E pranuar më 20 maj, 2020
Shqyrtimi i pranuar me 21 shtator, 2020
I aprovuar me 3 tetor, 2020
I publikuar online me 23 shkurt, 2021

Mirënjohjet

Autorët/autoret janë mirënjohëse kontributeve të Emily Cruikshank dhe Phillip Radetzki në këtë hulumtim.

Konflikte të interesit

Ky hulumtim nuk paraqet ndonjë konflikt të interesit.

Financimi

Ky hulumtim nuk është financuar.

Andrew J. Howell

Departamenti i Psikologjisë
Universiteti MacEwan
Edmonton, AB T5J 2P2
Kanadë
howella@macewan.ca

Andrew J. howell, PhD, R Psych, është profesor i psikologjisë në universitetin MacEwan, Edmonton, Alberta, dhe psikolog i regjistruar në provincën e Albertës, Kanadë. Interesat e tij të hulumtimit bijnë brenda shkencës së mirëqenies dhe përfshijnë teori të tërthorta të mirëqenies, ndikimit të natyrës në mirëqenie dhe stigmës.

Emilee R.H. Cowan-Nelson, BSc, është studente e diplomuar në neuroshkencë në universitetin e Calgary, Alberta, Kanadë.

Victoria D. Cobuz e ka përfunduar BSc në psikologji nga universiteti MacEwan Edmonton, Alberta, në vitin 2019.